



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 6717/ Prot.

Tiranë, më 27.10.2020

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes Nr.516/1, datë 08.09.1999.

SHOQËRISË “KRASTA” SH.P.K
Lagjia “Ndërkru”, banesë private njëkatëshe, Nr.4, Melcu, Krastë, Bashkia
Bulqizë, Qarku Dibër.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Kраста” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.516/1, datë 08.09.1999, për mineralin krom, në objektin “Kopshti i Kalit”, Njësia Administrative Krastë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me vendimin e Këshillit Teknik Nr.83/8, datë 18.09.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.6717 Prot, datë 22.09.2020, është propozuar revokimi i lejes së shfrytëzimit Nr.516/1, datë 08.09.1999, për mineralin krom, në objektin “Kopshti i Kalit”, Njësia Administrative Krastë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sepse shoqëria ka kërkuar të heqë dorë nga kjo leje minerare për shkak të konflikteve të pronësisë, duke ndërprerë aktivitetin minerar në këtë objekt.

Vendimi i Këshillit Teknik i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, mbështetur në kërkesën e shoqërisë ku propozohet revokimi i lejes së shfrytëzimit Nr.516/1, datë 08.09.1999, për mineral krom, në objektin “Kopshti i Kalit”, është i mbështetur në germën “a” të pikës 2, të Nenit 47, (neni që përcakton shkaqet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.516/1, datë 08.09.1999, për mineralin krom, në objektin “Kopshti i Kalit”, Njësia Administrative Krastë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.516/1, datë 08.09.1999, për mineralin krom, në objektin “Kopshti i Kalit”, Njësia Administrative Krastë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër .

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar, pajisur me lejen Nr.516/1, datë 08.09.1999.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

